



Adress: Rr. Nëna Terezë Nr 35 10000 Prishtinë      Tel: +381 38 222 859, +377 44 165 040 Email: [bspk@bspk.org](mailto:bspk@bspk.org)

Në mbështetje të nenit 10, pika 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut, nr.2003/13, me ndryshimet dhe plotesimet e Rregullores së UNMIK-ut 2004/45, e duke e zbatuar Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-16-0268-A0001, dt. 24.08.2017, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), me dt.18.04.2019,

### PUBLIKON

**NJOFTIMIN për punëtorët e Ndërmarrjes Shoqërore (NSH) "Rilindja – Gazeta", PRN142, Prishtinë, NSH "Osijek" PRZ076 – Rahovec, dhe NSH "Radio Televizioni i Prishtinës", PRN150, Prishtinë, e me qëllim të aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit të punëtorëve për këte NSH lidhur me hartimin e listës fillestare të punëtorëve në formatin tabelar excel për përfitim të një pjese prej 20% të të ardhurave nga privatizimi-likuidimi apo shpronësimi i NSH-ve të theksuara më lartë nga kompetenca e BSPK-së dhe ate:**

1. Libreza e punës (për punëtorët që i posedojnë), apo kontrata e punës pas qershorit 1999,
2. Të ardhurat personale nga Ndërmarrja përkatëse për punëtorët të cilët kanë punuar pas qershorit 1999, deri në privatizimin-likuidimin e NSH.
3. Në rast të mungesës të Librezës së punës, çfarëdo dokumenti tjetër (kontrata apo vendime të punës) që dëshmojnë themelimin e marrëdhënies së punës, përkatësisht përfundimin e punësimit në NSH,
4. Vendimin eventual për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për periudhën 1989-1999, gjatë aplikimit të masave të dhunshme diskriminuese nga ish Kuvendi i Republikës së Serbisë (nëse posedojnë këte vendim),
5. Dokumentet në komunat përkatëse, Dep. për çështje sociale për të rënë në Luftën e Kosovës 1997-1999, qoftë luftetarë të lirisë, por edhe të viktimave civile,
6. Çfarëdo dokumentacioni tjetër i cili dëshmon dhe arsyeton pretendimin për të drejtën e punëtorëve për t'u përfshirë në Listën fillestare të punëtorëve në formatin tabelar excel që do të hartohet nga menagjmenti dhe sindikata e NSH përkatëse në bashkëpunim me BSPK-në.
7. Ekstrakti i lindjes dhe kopjet e lejes së njoftimit,
8. Numrat e tel. kontaktues

Të gjitha dokumentet që do të dorëzohen duhet të jenë të noterizuara nga noteri kompetent, përveq lejes së njoftimit.

**Dokumentacioni dorëzohet në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, rr. "Qamil Hoxha" nr. 8, 10000 Prishtinë, personalisht apo përmes postës.**

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të punëtorëve është 30 ditë nga publikimi i njoftimit në mjetet shkruara të informimit publik.